

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
PREFEKTURËN E QARKUT FIER

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Prefekturën e Qarkut Fier**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 152, datë 10.11.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 619/9, datë 10.11.2014, i ka rekomanduar z. Xhevit Bushi, Prefekt i Qarkut Fier, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në inventar të institucionit në llogarinë 210 “Toka dhe terrene” paraqitet në vlerën 2,401,440 lekë. Në anekset e bilancit nuk është pasqyruar në mënyrë analitike vlera e sipërfaqes për çdo objekt ndërtimor në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pika 82.

1. Rekomandim: - Institucioni i Prefektit dhe Zyra e Financës të marrë masa dhe të ngrihet grup pune me specialist nga të cilët të kryhen matjet në vend sipas genplaneve e plan vendosjeve të sipërfaqes “Truall” për çdo objekt, dhe të sistemohet në inventar të institucionit në llogarinë 210 “Toka dhe terrene” vlera reale dhe në anekset e bilancit të pasqyrohet në mënyrë analitike vlera e sipërfaqes për çdo objekt.

Deri 15 Dhjetor 2014

2. Gjetje nga auditimi: Është nxjerrë Urdhër i Brendshëm nr. 161, datë 15.02.2013, drejtuar Zyrës Administrimit Financiar me objekt: Urdhëroj Zyrën e Administrimit Financiar të bëjë veprimet kontabile për transferimin e inventarit në përdorim të objektit Stacioni i PMNZSH-së Fier sipas dokumenteve hipotekore bashkëngjitur në pronësi të personave nënshkruar. Dhënia e urdhrat të gabuar nga titullari i njësisë publike, zbatimi i urdhrat të gabuar të titullarit nga nëpunësi zbatues dhe mospezullimi i veprimit nga punonjëse e thesarit është veprim në kundërshtim me nenin 13 dhe 14 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

2- Rekomandim: Institucioni i Prefektit të bëjë kërkesë në Ministrinë e Brendshme për marrjen e miratimit të kthimit të objektit PMNZSH qytetarit, në zbatim të nenit 13 dhe 14 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nuk janë ndjekur deri në fund procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit të mjeteve të transportit të cilat kanë mbetur stok dhe për 13 mjetet e tjera të vlerësuara nga komisioni për jashtë përdorimit nuk është kërkuar miratimi i ministrisë për nxjerrje jashtë përdorimit, mbasi komisioni i inventarizimit ka vlerësuar mjete transporti jashtë përdorimit 20 mjete nga 28 që janë në inventar, dhe nuk është vepruar sipas Ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin Publik”, ndryshuar me ligjin nr. 10346, datë 04.11.2010. Gjithashtu Titullarët e Njësisë Publike, Prefektët e Qarkut Fier duhet të kishin ngritur grupe vlerësimi dhe ekspertë për të bërë të mundur shitjen e tyre.

3. Rekomandim: Institucioni i Prefektit dhe Zyra e Financës të marrë masa dhe të ngrejë grup pune me specialistë të fushës për vlerësimin e mjeteve të transportit të nxjerra jashtë përdorimit

dhe të miratuar nga ministria për shitje për “Skrap”, ndërsa për 13 mjetet e tjera të vlerësuara nga komisioni për jashtë përdorimit të kërkohet miratimi i ministrisë për miratim për nxjerrje jashtë përdorimit, mbasi komisioni i inventarizimit ka vlerësuar mjete transporti jashtë përdorimit 20 mjete nga 28 që janë në inventar dhe të vazhdojë zbatimin e procedurave ligjore në zbatim të Ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin Publik”, ndryshuar me ligjin nr. 10346, datë 04.11.2010. Gjatë kësaj periudhe Titullarët e Njësive Publike, Prefektët e Qarkut Fier duhet të kishin ngritur grupe vlerësimi dhe ekspertë për të bërë të mundur shitjen e tyre.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Janë kryer shpenzime për riparim të mjetit të prefektit për vlerën 220,000 lekë dhe si rezultat i mosrakordimit të vlerës së preventivit me vlerën e situacionit, rezultoi se vlera e shpenzimeve të kryer në total sipas situacionit për riparim nuk ka ndryshuar, por ndryshojnë vlera e shpenzimeve për 2 zëra “Lyerje dhe pjekje” në preventiv planifikuar 48,000 lekë në situacion 65,000 lekë me diferencë më tepër në vlerën 17,000 lekë dhe “larje tapeti” preventivi në vlerën 10,000 lekë në situacion në vlerën 15,000 lekë me diferencë më tepër në vlerën 5,000 lekë. Ndërsa është ulur vlera në blerje diferenciali nga 50,000 lekë në preventiv në vlerën 28,000 lekë, për më pak në vlerën 22,000 lekë, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 30.1.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”.

4. Rekomandim:- Institucioni i Prefektit dhe Zyra e Financës të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësinë ndaj anëtarëve të komisionit B.Xh., Sh.K., A.S., Z.H. për kryerjen e shpenzimeve për riparim të mjetit të prefektit për vlerën 220,000 lekë, mosrakordimin e vlerës së preventivit me vlerën e situacionit, dhe për uljen e vlerës në blerjes së një diferenciali nga 50,000 lekë në preventiv në vlerën 28,000 lekë, për më pak në vlerën 22,000 lekë, në zbatim të VKM nr.1, datë 30.1.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Zyra e Financës nuk ka kryer rakordimin dhe ka detyrime për konsumin e energjisë elektrike ndaj ÇEZ, mbasi nga auditimi rezultoi se Prefektura i detyrohet ÇEZ për konsumin e ujit për periudhën Maj deri Dhjetor 2013 në vlerën 780,120 lekë, mbasi të dy subjektet nuk kanë rënë dakord nga rakordimet e kryera. Kjo shumë nuk është kontabilizuar në kontabilitet por mbahet nga jashtë në evidencë, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

5. Rekomandim: Zyra e Financës të marrë masa për kryerjen e rakordimit dhe të bëhen shlyerjet e detyrimeve për konsumin e energjisë elektrike ndaj ÇEZ, dhe për konsumin e ujit për periudhën Maj deri Dhjetor 2013 në vlerën 780,120 lekë, dhe kjo shumë të kontabilizohet e të mos mbahet nga jashtë në evidencë, në zbatim të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në Stacionin e PMNZSH-së Patos ndodhen prej vitesh jashtë funksioni 10 mjete transportit gjendje inventar të për të cilat nuk është marrë asnjë veprim, mosveprim ky në kundërshtim të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 dhe UMF nr. 30, datë 29.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

6. Rekomandim: Institucioni i Prefektit dhe Stacioni i PMNZSH-së Patos të marrin masat e nevojshme për vënien e efikasitetit dhe menaxhimin e të 10 mjeteve transportit gjendje inventar jashtë funksioni ndodhur në stacionin e PMNZSH-së Patos, në zbatim të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 dhe UMF nr. 30, datë 29.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i brendshëm nuk është bërë mjaftushmërisht vetëvlerësimi mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, sipas komponentëve, sipas kërkesave të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, ligjit Nr. 9720 datë 23.04.2007 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

7. Rekomandim: Të bëhet vetëvlerësimi mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, sipas komponentëve, duke paraqitur: mjedisin e kontrollit; aktivitetet e kontrollit dhe monitorimin, në zbatim të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 , ligjit nr. 9720 datë 23.04.2007 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi:Gjatë periudhës 2012-2014 janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 46 punonjës ose 61% të sektorit të PMNZSH-së nga ana e Prefektit të Qarkut Fier, bazuar në propozimet e paargumentuara dhe arsyetuara e bëra nga shefi i sektorit të PMNZSH-së për lirim nga detyra të punonjësve të kësaj njësie ku të gjithë punonjësit e liruar kanë fituar proceset gjyqësore dhe për pasojë kanë lindur detyrimet e Prefekturës. Këto veprime kryer nga ana e Prefekturës janë në kundërshtim me nenin 10 dhe 13 të ligjit nr. 8766 datë 05.04.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi” i ndryshuar, dhe pika 11. Të Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit. nr. 1 datë 14.01.2002 si dhe me ligjin për Kodin e Punës.

8. Rekomandim: Nga ana e Prefektit të Qarkut Fier, për lirim nga detyra të punonjësve të sektorit të PMNZSH-së të argumentohet arsyeja e lirit si në propozimet e bëra nga shefi i sektorit të PMNZSH-së dhe në urdhrat e lirit nga detyra të dhëna nga titullarin zbatim të nenit 10 dhe 13 të ligjit nr. 8766 datë 05.04.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi” i ndryshuar, dhe pika 11 e Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit. nr. 1 datë 14.01.2002 si dhe ligjit për Kodin e Punës..

Në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi:Nuk janë marrë nën administrim, e nuk janë përfshirë në inventar dhe në evidencën kontabile vlera në lekë e dy mjeteve transportit përkatësisht: mjeti tipi “Land Rover” me numër shasie SALLTGM97YA255423 i cili përdoret nga PMNZSH-së“Azotik, Fier, së bashku me pajisjet e shpëtimit (sipas Akt-Dhurimi datë 10.04.2009), dhe Mjeti transportit tip “VOLVO” i dhuruar nga zjarrfikësit Britanik në vitin 2008,icili përdoret nga PMNZSH-së“ Lushnje, mosveprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me ”UMF nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” kreu III pika 57.

9. Rekomandim: Prefekti Qarkut Fier Drejtorja e PMNZSH-së dhe Drejtorja e Financës të marrin nën administrim, e të përfshijnë në inventar dhe në evidencën kontabile pasi të bëjnë vlerësimin real, të regjistrohet në kontabilitet dhe pastaj ti bëhen dalje stacioneve të PMNZSH-së“Azotik, e Lushnje Fier mjeti tipi “Land Rover” me numër shasie SALLTGM97YA255423 icili përdoret nga PMNZSH-së“Azotik, Fier, së bashku me pajisjet e shpëtimit (sipas Akt-Dhurimi datë 10.04.2009), dhe Mjeti transportit tip “VOLVO” i dhuruar nga zjarrfikësit Britanik në vitin 2008, icili përdoret nga PMNZSH-së“ Lushnje, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me ”UMF nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” kreu III pika 57.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi:Njësia e Auditimit të Brendshëm në Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier, nuk ka kërkuar zyrtarisht zbatimin e rekomandimeve ndaj subjekteve të audituara, mosveprim në kundërshtim të ligjit nr. 9720 datë 23.04.2007, i ndryshuar, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, dhe VKM nr. 70 dt 18.04.2006 “Për zbatimin e rekomandimeve të kontrollit të brendshëm administrativ dhe antikorrupsion, në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit a të Ministrave”.

10. Rekomandim: Njësia e Auditimit të Brendshëm në Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier, për subjektet që nuk kanë zbatuar rekomandimet e dhëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, ti kërkohej zyrtarisht zbatimi i tyre në zbatim të Ligjit nr. 9720 datë 23.04.2007, i ndryshuar, “Për

Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, dhe VKM nr. 70 dt 18.04.2006 “Për zbatimin e rekomandimeve të kontrollit të brendshëm administrativ dhe antikorrupsion, në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit a të Ministrave”.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Lidhur me rregullshmërinë e ngritjes, funksionimin dhe efikasitetin e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Fier, në përbërje të Komisionit ka ***munguar pozicioni i specialistit “Inxhinier Gjeodet”*** ose “Topograf i licencuar”, në kundërshtim me VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 “Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, Kreun III, germa “A”, Pika 2 “Përbërja dhe mënyra e funksionimit”

Mungojnë miratimi nga KQT i Programeve Vjetor 2009-2014 i Kontrollit dhe Verifikimit, të Titujve të Pronësisë, i përgatitur nga KVVTP-së Fier, dhe i shqyrtuar e i miratuar, në kundërshtim me Kreun e I, germa “B”, pika 1 të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 “Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore

mungojnë e nuk janë hapur sipas formës e përmbajtjes tip me të dhënat përkatëse në libra të veçantë: dokumenti “**Regjistri i Vendimeve**”, dhe vendimet mbahen e raportohen në menynë sporadike, në fletë të shkëputura dhe me të dhënat jashtë formës së standardit – tip të miratuar. në kundërshtim me nenin 14, pika 3, paragrafi i katërt të Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e KVVTP”, miratuar me Vendimin nr. 1, datë 27.3.2009 të KQT,

Ka parregullsi në inventarizimin e Vendimeve të marra, (vendime që në vetvete vlerësohen si tituj pronësie), që lidhen me mangësitë:

-Mungon ruajtja e numrit progresiv që identifikon dhe individualizon çdo vendim, ndërsa është vepruar për çdo fillim viti duke filluar nga numri 1, praktikë kjo e parregullt pasi sjell përsëritjen e numrit të vendimit nga njëri vit në tjetrin, ndërkohë që “Regjistri i Vendimeve” nuk është mbajtur në formë libri sipas formatit –tip të miratuar ,Kreu II, pika sipas Modelit lidhja”D” 2, germa “c”, “a”, paragrafi (iii), të UKM nr.2, datë 13.1.2010”Për Mënyrën e verifikimit apo shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e kërkojnë Individë a Institucione”.

Pra për periudhën 2009-2014 konstatohet ritëm dhe ecuri e ngadaltë si dhe performancë e ulët e punës së KVVTP-së krahasuar me numrin e kërkesave

Mungon dhe nuk është çelur “Regjistri i kërkesave” ndërsa sistemi i evidencave dhe i Raportimeve të gjendjes së secilës kërkesë sipas stadi dhe gjendjes në fillim të çdo viti muaji etj, është me mangësi që tregon se:

Sistemi statistikor i evidentimit dhe i Raportimit nuk është real e në pasqyrim të gjendjes që ka sjellë si pasojë mungesën e ndjekjes së ecurisë së procesit të vlerësimit të titujve të pronësisë dhe fenomenit në tërësi në rajonin juridiksional të Prefekturës në funksion të kohës dhe kapaciteteve, dhe mungesën e punës studimore sipas njësive territoriale, nuk krijon mundësinë e ndjekjes e trajtimit në kronologji të zgjidhjes e trajtimit të kërkesave, progresivisht sipas procedurave dhe afateve kohore, uljen ose mungesën e transparencës për cilësinë e shërbimit ndaj Publikut nga gjithë institucionet dhe NJQV-të që kanë detyrimin ligjor të verifikim - vlerësimit të titujve të pronësisë.

Ka munguar, sistemi i informacionit IT, evidencave etj, dhe dokumentacioni ndodhej i pa arkivuar, kryesisht i pa inventarizuar, dhe i pa marrë e dorëzuar nga drejtorët e specialistët, ndërsa ***informacioni tjetër i IT*** dhe statistikave nuk administrohej nga institucioni por i shpërndarë dhe i pjesshëm mbahej në Laptopë privatisht nga specialistët, pra mungesë administrimi dhe dorëzimi i (KNOW-HOW).

Nuk është vendosur e nuk funksionon shërbimi i IT dhe punonjësi përkatës, për evidentimin, paraqitjen e dokumentimin, ndjekjen e ecurisë sipas stadi të zgjidhjes së kërkesave të,

institucioneve qytetarëve, që ndërmjet të tjerash ka sjellë si pasojë mungesën e një evidencë të saktë të tyre të raportuar të ecursisë sipas stadeve për periudhën 2012-2014, pamundësinë e kryerjes së studimeve lidhur me rajonizimin e problematikave të titujve të pronësisë, ndonëse kërkesat zënë një numër të konsiderueshëm nisur nga fakti që për çdo vit ato raportohen rreth 1500-2000 kërkesa.

11. Rekomandim -Institucioni i Prefektit të Qarkut dhe KVVTP, të marrin masat për plotësimin e përbërjes, përmirësimin e funksionimit, vënien në efikasitet, vendosjen e IT, administrimin e kërkesave dokumentacionit evidencave celjen dhe mbajtjen e regjistrave të kërkesave, regjistrat të vendimeve dhe regjistrat të ankimimeve, deri tani të munguara dhe të marrë nën administrim informacionin dhe data bazen (know-how), në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” UMF nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” i ndryshuar VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 “Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e KVVTP”, miratuar me Vendimin nr. 1, datë 27.3.2009 të KQT,

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Marrëdhëniet me Komisionin Qeveritar të Ndarjes së Tokës, Sekretariati Qendror Teknik pranë **Komisionit Qeveritar të Ndarjes së Tokës** nuk ka dërguar Programet Vjetor të Kontrollit dhe Verifikimit, të Titujve të Pronësisë, i përgatitur nga KVVTP-së Fier, dhe i shqyrtuar e i miratuar nga KQT, në asnjë prej vireve 2009- 2014, mosveprim në kundërshtim me Kreun e I, germa “B”, pika 1 të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 “Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore

- Nga Sekretariatit Teknik i KQT nuk përcaktohet një formë standarde apo Formular-tip i “Regjistrat të Kërkesave”, kështu që forma e këtij regjistri është mbajtur si regjister korrespondence, gjë që nuk i shërben pasqyrimin të ndjekjes së ecursisë së trajtimit të kërkesës sipas stadeve, procedurave të ndjekura, që do të sillte pasqyrimin e qartë të afateve, dokumentacionit, rritjen e transparencës, llogaritjen e kapaciteteve dhe pasqyrimin e punës së KVVTP sipas periudhave, në plotësim të detyrimit të nenit 7, pika 1 të Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e KVVTP”, miratuar me Vendimin nr. 1, datë 27.3.2009 të KQT,

Gjithashtu sistemi i evidencave dhe i Raportimeve i kërkuar nga ky institucion i gjendjes së secilës kërkesë sipas stadi dhe gjendjes në fillim të çdo viti muaji etj, është i pamjaftueshëm dhe nuk i përgjigjet ndjekjes mbikëqyrjes së procesit dhe me mangësi që tregon se:

a. Sistemi statistikor i evidentimit dhe i Raportimit nuk është real e në pasqyrim të gjendjes që ka sjellë si pasojë mungesën e ndjekjes së ecursisë së procesit të vlerësimit të titujve të pronësisë dhe fenomenit në tërësi në rajonin juridiksional të Prefekturës në funksion të kohës dhe kapaciteteve, dhe mungesën e punës studimore sipas njësive territoriale,

b. Nuk krijon mundësinë e ndjekjes e trajtimit në kronologji të zgjidhjes e trajtimit të kërkesave, progresivisht sipas procedurave dhe afateve kohore,

c. Uljen ose mungesën e transparencës për cilësinë e shërbimit ndaj Publikut nga gjithë institucionet dhe NJQVp-të që kanë detyrimin ligjor të verifikim - vlerësimit të titujve të pronësisë.

-Për periudhën e auditimit dhe prej vitit 2009-2014, kanë munguar kontrollat në KVVTP Fier, nga Sekretariati Teknik i KQT, pasi nuk u paraqit asnjë dokumentacion mosveprim ky në mosplotësim të detyrimit sipas Kreut V-të , neni 23, pikat 1,2,3,4,5 të Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e KVVTP”, miratuar me Vendimin nr. 1, datë 27.3.2009 të KQT.

-Gjithashtu për periudhën objekt auditimi, kanë munguar trajnimet nga Sekretariati Teknik i KQT me stafin e KVVTP Fier, apo dhe forma të tjera të shkëmbimit të eksperiencës me qarkore të ndryshme, apo kontaktet me KVVTP me eksperiencë.

- Ka munguar mbështetja me fonde për ngritje e instalimin sistemin e informacionit IT, evidencave lidhur me dokumentacionin, etj, dhe ai **informacioni tjetër i IT** dhe statistikave nuk administrohej nga institucioni por ndodhej i shpërndarë dhe i pjesshëm i mbajtur në Laptopë privatisht nga specialistët, pra mungesë administrimi dhe dorëzimi i (KNOW-HOW) gjendje kjo **në kundërshtim me legjislacionin për periudhën e mëparshme dhe me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”**.

12.Rekomandim: Sekretariati Qendror Teknik prane Komisionit Qeveritar të Ndarjes së Tokës pas njohjes me Raportin Përfundimtar të Auditimit të analizojë gjendjen, nxjerrë përgjegjësitë për gjendjen e verifikimit të Titujve pronësisë në KVVTP Fier, dhe të marrë masat e plotësojë detyrimet lidhur me:

12.1 Miratimin e formatit-tip të Regjistrimit të Kërkesave, si dokument bazë i evidentimit, ndjekjes së ecursisë së kërkesave sipas stadeve, në funksion të respektimit të procedurave të afateve ligjore dhe të rritjes së transparencës ndaj publikut , në zbatim të KPA, ligjit nr. 9948 dhe të rregullores.

Menjëherë

12.2. Përmirësimin dhe përsosjen e sistemit të evidencave dhe raportimeve në funksion të gjendjes së secilës kërkesë sipas stadit dhe gjendjes në fillim të çdo viti muaji etj, në funksion të ndjekjes e mbikëqyrjes së procesit.

Menjëherë

12.3. Përmirësimin e Sistemit statistikor të evidentimit dhe Raportimit real e në pasqyrim të gjendjes me synim përshpejtimin e procesit të vlerësimit të titujve të pronësisë në shkallë vendi në tërësi dhe në juridiksion të Prefekturës, në funksion të kohës dhe kapaciteteve, nëpërmjet rritjes së punës studimore sipas njësive territoriale, ndjekjes e trajtimit në kronologji të zgjidhjes së kërkesave, progresivisht në zbatim të procedurave dhe afateve kohore, dhe rritjen e transparencës për cilësinë e shërbimit ndaj Publikut nga gjithë institucionet dhe NJQV-të që kanë detyrimin ligjor të verifikim - vlerësimit të titujve të pronësisë.

Menjëherë

12.4 Rritjen e nivelit të mbikëqyrjes dhe ushtrimin e kontrolleve të ecursisë dhe zbatimit të ligjshmërisë së procesit, pasi për periudhën e auditimit dhe prej vitit 2009-2014, kanë munguar kontrollet në KVVTP Fier, nga Sekretariati Teknik i KQT, pasi nuk u paraqit asnjë dokumentacion mosveprim ky në mosplotësim të detyrimit sipas Kreut V-të , neni 23, pikat 1,2,3,4,5 të Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e KVVTP”, miratuar me Vendimin nr. 1, datë 27.3.2009 të KQT.

Në vijimësi

12.5 Përdorimin e formave të trajnimit të stafëve apo dhe forma të tjera të shkëmbimit të eksperiencës me qarkore të ndryshme, apo kontaktet me KVVTP me eksperiencë.

Në vijimësi

12.6. Mbështetja me fonde për ngritje e instalimin sistemin e informacionit IT, për krijimin e data baze-ës të evidencave lidhur me dokumentacionin dhe **informacioni tjetër i IT** dhe statistikave, vënien nën administrim nga institucioni të (KNOW-HOW) të periudhës 4 vjeçare **në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik**”; të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore” i ndryshuar, VKM nr.1269, datë 17.9.2008 “Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP-ve” të miratuar me vendimin nr.1, datë 27.03.2009 të KQT-së, si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në zbatim të tyre.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Mbi marrëdhëniet e KVVTP me ZVRPP lidhur me dërgimin e vendimeve me pavlefshmëri absolute të titujve të pronësisë.

a. Janë marrë vendime për pavlefshmëri të AMTP-ve

- ***Për periudhën 2013-6/muaj. I 2014 në 24 raste vendime*** me mbi **32 pasuri** me sipërfaqen **135761m²** të llojit Tokë Bujqësore,

- ***Për vitet 2009-2012 në 15 raste vendime*** me **19 pasuri** me sipërfaqen prej **139 893 m²** të llojit Tokë Bujqësore, troje etj.

dhe nuk është bërë njoftimi i këtyre vendimeve pranë kërkuesit ZVRPP, pra për pasojë pasuritë me sipërfaqe përkatëse juridikisht ndodhen në duart e mbajtësve për faktin se ZVRPP-ja duke mos u njoftuar zyrtarisht nuk i është dhënë mundësia për të vendosur fillimisht kufizimin dhe pas marrjes së njërës prej 6 kopjeve të vendimit do të mund të kryente regjistrimin e këtyre sipërfaqeve në pronësi “Shtet”, pra, kalimin e titujve të pronësisë të verifikuara e të mbajtura padrejtësisht nga poseduesi te pronari “Shtet”. Këto veprime vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 “*Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore*” i ndryshuar, dhe me ligjin nr. 33/2012 datë 21.03.2012 “*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*”, me rregulloren “*Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP-ve*” të miratuar me vendimin nr. 1, datë 27.03.2009 të KQT-së.

b. Vendimet e marra dhe të shpallura nuk kanë formën dhe përmbajtjen e duhur në funksion të lehtësimit në fazën e ekzekutimit pasi:

- Nuk përcaktohet identifikimi i treguesve përcaktues të pasurisë sipas të dhënave të Kartelave të Pasurisë Paluajtshme(KPP) si: nr.,Vol, Faqe, ZK zona kadastrale, vendndodhja, të pasurisë objekt “Kthimi shtet”. Këto të dhëna sigurohen nga shkresa konfirmuese e gjendjes juridike dërguar nga ZVRPP të pasurisë objekt vlerësimi të titullit të pronësisë.

-Në vendim nuk shprehet si palë ZVRPP, e cila do të përfundojë regjistrimin, pra zbatimin përfundimtar të Vendimit të KVVTP, dhe apo sipas rastit edhe të vendimit të gjykatës, nëse do ketë. Ky mosveprim ka sjellë vendime të pa plota ose të paqarta apo të pasakta, me pasojë vështirësinë ose pa mundësinë e zbatimit të tyre; pra titulli i pronësisë “shtet” formalisht mbetet në duart e poseduesit, edhe pse është shpallur i pavlefshëm, për shkak të mbetjes i pa regjistruar në pronësinë e “shtetit”.

- Gjithashtu mos përfshirja e ZVRPP si palë në Vendimet e KVVTP ka sjell mos përfshirjen në kërkesë-paditë drejtuar gjykatës, pra dhe në Vendimin përkatës të gjykatës.

c. Mungon dorëzimi i këtyre sipërfaqeve Komunave ose Bashkive, sipas germës a, dorëzimi në Zyrën Rajonale të AKKP, sipas germës b, sipas VKM nr. 567, datë 5.9.2007 “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave, përcaktimin e pronarëve fond pasurie të paluajtshme, për kompensim fizik” dhe sipas VKM nr. 868, datë 18.6.2008 “Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi i tokës bujqësore “, mosveprim në kundërshtim me kreun III, germa “B”, pika 4, germa a,b të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 “ Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”.

13.1 Rekomandim: Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier pasi të analizojë e nxjerrë përgjegjësinë dhe pasi të identifikojë gjendjen juridike dhe treguesit identifikues të pasurive **objekt** në **24 raste vendime** me mbi **32 pasuri** me sipërfaqen **135761 m²** të llojit Tokë Bujqësore, të **periudhës 2013-6/muj.I 2014** dhe **15 raste vendime** me 19 pasuri me sipërfaqen prej **139 893 m²** të llojit Tokë Bujqësore, troje etj të **viteve 2009-2012**, si dhe pasi të rishqyrtojë Vendimet e KVVTP, **ti dërgojë në ZVRPP Fier**, në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 “*Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore*” i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 33/2012 datë 21.03.2012 “*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*”, si dhe të rregullores “*Për*

organizimin dhe funksionimin e KVVTP-ve” miratuar me vendimin nr. 1, datë 27.03.2009 të KQT-së.

Menjëherë

13.2. Rekomandim: -Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier KVVTP të rishqyrtojë, rregullojë, rishkruaj dhe plotësojë si në formë ashtu dhe në përmbajtje vendimet e konstatuara me mangësi.

Deri 15 Dhjetor 2014

13.3 Rekomandim: Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier KVVTP të evidentojë në regjistrat përkatës, raportojë e dorëzojë me procesverbal përkatësisht Komunave ose Bashkive, ***sipërfaqet prej 400 367 m² të 81 pasurive*** që i përkasin ***58 vendimeve*** të marra, të dërguara dhe pa dërguara në ZVRPP, në zbatim të gurmës a, dorëzimi në Zyrën Rajonale të AKKP, sipas gurmës b, sipas VKM nr. 567, datë 5.9.2007 “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave, përcaktimin e pronarëve fond pasurie të paluajtshme, për kompensim fizik” dhe sipas VKM nr. 868, datë 18.6.2008 “Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi i tokës bujqësore”, në zbatim të kreut III, germa “B”, pika 4, gerrat a,b të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 “Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore

Deri 15 Dhjetor 2014

14. Gjetje nga auditimi:a. Nga KVVTP, janë humbur proceset gjyqësore pa shkaqe të justifikuara për Vendimet KVVTP nr.13/1, datë 28.01.2010, nr.13/2, datë 28.01.2010 dhe nr.13/3, datë 28.01.2010, për mosplotësim dokumentacioni në shoqërim të kërkesë padive, mos pjesëmarrje në seancat gjyqësore, mos identifikim të pasurive, mos ushtrim të së drejtës së ankimimit brenda 5 dhe 15 ditëve, mangësi këto që kane sjellë kthimin e akteve (padive) me pasojë shpalljen e pavlefshme të 3 vendimeve për sipërfaqen prej ***7300 m²***, që ka shkaktuar dëmin ekonomik në vlerën ***3,359,200 lekë*** nga mbajtja dhe përfitimi i padrejtë nga shitja e pasurisë me tituj pronësie të pavlefshëm; pra veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 9948 datë 07.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore” i ndryshuar, me rregulloren e “Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP-ve” të miratuar me vendimin nr. 1, datë 27.03.2009 të KQT-së/

b. Gjithashtu në vendimin nr.13/1, datë 28.01.2010, është lënë jashtë trajtimit pasuria me nr. 270/30, V.10, f.194, Zk 3031, me sipërfaqe ***1400 m²***, e cila disponohet nga mbajtësi i parë, pjesë e sipërfaqes prej 2900 m² vlerësuar me titull ligjor të pavlefshëm dhe në vendimin e KVVTP duhej të shprehej “Kthim në Shtet”, pra mosveprim ky **duke lejur titull të kundërligjshëm të pasurisë,** në kundërshtim me ligjin nr.9948, datë 07.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore” i ndryshuar, nenet nr. 9, 10.

14.1 Rekomandim:-Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier të analizojë e nxjerrë përgjegjësinë si dhe të rinisë procedurat gjyqësore pasi të identifikojë pasuritë dhe të përfshijë si palë ZVRPP Fier, si dhe plotësojë kërkesë paditë me dokumentacionin përkatës lidhur me Vendimet KVVTP nr.7, nr.13/1, datë 28.01.2010, nr.13/2, datë 28.01.2010 dhe nr.13/3, datë 28.01.2010 për sipërfaqen prej ***7300 m²*** që ka shkaktuar dëmin ekonomik në vlerën ***3,359,200 lekë*** nga mbajtja dhe përfitimi i padrejtë i pasurisë me tituj pronësie të pavlefshëm (pasurisë “shtet”), në zbatim të ligjit nr.9948 datë 07.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore” i ndryshuar, dhe rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP-ve” të miratuar me vendimin nr.1, datë 27.03.2009 të KQT-së.

Deri 15 Dhjetor 2014

14.2 Rekomandim: -Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier nëpërmjet KVVTP gjithashtu, të rishqyrtojë vendimin nr.13/1, datë 28.01.2010, ku është lënë jashtë trajtimit pasuria me nr.270/30, V.10, f.194, Zk 3031, me ***sipërfaqe 1400 m²*** pjesë e sipërfaqes prej 2900 m² vlerësuar me titull ligjor të pavlefshëm dhe shprehet të regjistrohet kjo pasuria “Shtet”, si dhe ti njoftohen evidentohen e raportohen ZAKKP Tiranë.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Janë humbur proceset gjyqësore pa shkaqe të justifikuara për Vendimet KVVTP nr.7/1, nr.7/2, nr. 7/3, nr.7/4, dhe nr.7/5, datë 26.11.2009, ripërsëritur me vendimet nr.77/1, nr.77/2, nr. 77/3, nr.77/4, dhe nr.77/5, datë 02.06.2011, për mosplotësim dokumentacioni në shoqërim të kërkesë padive, mos pjesëmarrje në seancat gjyqësore, mos identifikim të adresave, mos ushtrim të së drejtës së ankimit brenda 5 dhe 15 ditëve, mangësi këto që kane sjellë kthimin e akteve (padive) me pasojë shpalljen e pavlefshme të 5 vendimeve për herë të dytë për një sipërfaqe prej **45 700 m²** që ka shkaktuar dëmin ekonomik në vlerën **11,927,700 lekë** nga mbajtja dhe përfitimi i padrejtë nga shitja e pasurisë me tituj pronësie të pavlefshëm; pra për veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin nr.9948, datë 07.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore” i ndryshuar, me rregulloren e “Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP-ve” të miratuar me vendimin nr.1, datë 27.03.2009 të KQT-së.

15. Rekomandim:- Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier të analizojë e nxjerrë përgjegjësinë si dhe të rinisë procedurat gjyqësore pasi të identifikojë pasuritë dhe të përfshijë si palë ZVRPP Fier, si dhe plotësojë kërkesë paditë me dokumentacionin përkatës lidhur me Vendimet KVVTP nr.7/1, nr.7/2, nr. 7/3, nr.7/4, dhe nr.7/5, datë 26.11.2009, ripërsëritur me vendimet nr.77/1, nr.77/2, nr. 77/3, nr.77/4, dhe nr.77/5, datë 02.06.2011, për sipërfaqen prej **45 700 m²** që ka shkaktuar dëmin ekonomik në vlerën **11,927,700 lekë** nga mbajtja dhe përfitimi i padrejtë i pasurisë me tituj pronësie të pavlefshëm (pasurisë “shtet”), në zbatim të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore” i ndryshuar, dhe rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP-ve” të miratuar me vendimin nr.1, datë 27.03.2009 të KQT-së..

Deri 15 Dhjetor 2014

Pra, nga mosplotësimi i dokumentacionit të kërkesë padive, mosndjekja e gjyqeve janë shkaktuar dëm ekonomik dhe të ardhura të munguara në vlerën totale 14,286,900 lekë për sipërfaqen 53000 m² shpallur me vendime për tituj pronësie të pavlefshëm.

16. Gjetje nga auditimi: Të gjitha dosjet e trajtimit të kërkesave dhe vendimmarrjes janë të pa inventarizuara me numër fletësh progresiv sipas dokumentacionit përbërës dhe të pa dorëzuara në arkivën e Institucionit të Prefektit, në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat në RSH” .

16. Rekomandim: KVVTP të inventarizojë **dosjet** me numër fletësh progresiv sipas dokumentacionit përbërës dhe të dorëzojë në zbatim të ligjit nr.9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat”.

Deri 31 Dhjetor 2014

B . MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetje nga auditimi: Kanë tërhequr nga Ministria e Brendshme karburante në vlerën totale 258,000 lekë, përkatësisht nga ish punonjësit A.K. në vlerën 206,400 lekë dhe Xh.Gj. në vlerën 51,600 lekë, dhe sasia e karburantit nuk është bërë hyrje në magazinë. Ky veprim është në kundërshtim me pikat 35, 36, 37,38,39, dhe 40 të Kreut të III-të të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30 datë 27.12.2011” Për Menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit Publik”.

1.Rekomandim: Mbështetur në ligjin nr. 8927, datë 25.7.2002 “Për Prefektin”, Kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, nga Prefekti Qarkut Fier të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën 258,000 lekë si më poshtë:

1.Shuma 258,000 lekë, shpërblim dëmi nga A.K. në vlerën 206,400 lekë dhe Xh.Gj. në vlerën 51,600 lekë, për tërheqje karburanti dhe të pa bërë hyrje në magazinë. Veprim në kundërshtim me

pikat 35, 36, 37,38,39, dhe 40 të Kreut të III-të të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30 datë 27.12.2011” Për Menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit Publik”.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, dhe në ligjin nr. 8927, datë 25.7.2002 “Për Prefektin”, Kreu IV, neni 19 si dhe në kontratën individuale të punës, neni 8.4, i **rekomandojmë Prefektit të Qarkut Fier**, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, për punonjësit përgjegjës si më poshtë:

a. “Vërejtje”, bazuar në Kontratën individuale të punës shkronja (a), për 3 punonjësit si më poshtë:

1. **znj. P.H.** me detyrë agronome, komisioneve.
2. **znj. E.J.** me detyrë juriste, komisionere prej shkurtit 2013.
3. **znj. Amarda Xhelaj** me detyrë juriste, komisionere prej Shkurtit 2013.

b. “Vërejtje me paralajmërim”, bazuar në Kontratën individuale të punës shkronja (b), për 8 punonjësit si më poshtë :

1. **znj. O.H.** me detyrë juriste, komisionere prej Shtatorit 2010.
2. **z. R.B.** me detyrë Jurist, komisioner.
3. **z. B.Ç.** me detyrë agronom, ish-komisioner deri Maj 2013.

D. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL.

a). Për 2 ish drejtues dhe komisioner nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla , pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte **“largim nga puna”**, përkatësisht:

1. **z. A.D.** me detyrë ish-Drejtor deri Prill 2014.
2. **znj. A.Gj.** me detyrë ish-juriste, komisionere, deri në shkurt 2012.
-Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore” i ndryshuar, me rregulloren e “Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP-ve” të miratuar me vendimin nr.1, datë 27.03.2009 të KQT-së, për mosplotësim dokumentacioni në shoqërim të kërkesë padive, mos pjesëmarrje në seancat gjyqësore, veprime e mosveprime në kundërshtim me VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 “ Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, VKM nr. 567, datë 5.9.2007 “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave, përcaktimin e pronarëve fond pasurie të paluajtshme, për kompensim fizik” dhe sipas VKM nr. 868, datë 18.6.2008 “Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi i tokës bujqësore “, etj.
-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor të verifikimit dhe vlerësimit të titujve të pronësisë së tokës bujqësore, sipas trajtimit në procesverbale dhe në kapitujt përkatës të Raportit Përfundimtar të Kontrollit, të paraqitur për KVVTP Prefektit të Qarkut Fier.

Për **2 ish** drejtuesit dhe ish punonjësit e mësipërm, nga **Prefekti i Qarkut Fier** të njoftohet Ministri i Drejtësisë dhe Departamenti i Administratës Publike për masat disiplinore me qëllim kryerjen e regjistrimeve të nevojshme në Regjistrin Qendror të Personelit.

Nga Prefekti Fier, me shkresë nr. 812/46, prot, datë 02.12.2014, protokolluar në KLSH me nr.619/11 datë 15.12.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Piro Imeraj, Selfo Zeneli dhe Sotir Kosdine më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT